



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 366, Datë 15.12.2023

MBI

LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 74, DATË 13.04.2022

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20 gërma “c”, 83 dhe 85 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.06.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2230/5 prot., datë 13.12.2023 të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 325, datë 14.12.2022, ka vendosur ndër të tjera: (1) të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2023, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal ose konstatimit të ndryshimit të kostove bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- ERE me shkresën nr. 2230 prot., datë 03.10.2023, ka sjellë në vëmendje të shoqërisë FSHU sh.a., detyrimin për të aplikuar për përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal, në përputhje me nenin 5, pika 3 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal” dhe nenin 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016.
- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 6836/3 prot., datë 30.10.2023, ka bërë me dije se edhe për vitin 2024 pritet që shoqëria KESH sh.a., të vazhdojë të furnizojë me energji FSHU sh.a.,

me çmime të reduktuara duke patur si synim mosndryshimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për klientët fundorë të cilët shërbehen nga FSHU sh.a.. Sipas parashikimeve të FSHU sh.a., çmimet e rregulluara të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a., sigurojnë mbulim të shpenzimeve të reduktuara të FSHU sh.a. dhe një performancë minimale pozitive mbijetese. Në këto kushte, shoqëria FSHU sh.a. për vitin 2024 ka kërkuar që çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, sipas vendimit të bordit të ERE-s nr. 325, datë 14.12.2022, të mos ndryshojnë.

- Në vijim, ERE me anë të shkresës nr. 2230/2 prot., datë 15.11.2023, ka kërkuar nga shoqëria FSHU sh.a. të paraqesë në ERE të gjithë të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm lidhur me ushtrimin e aktivitetit të saj.
- Në përgjigje të shkresës së ERE me nr. 2230/2 prot., datë 15.11.2023, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 6836/5 prot., datë 06.12.2023, ka bërë me dije se për shkak të vonesave në vlerësimin e asetëve të OSHEE Group, kryer nga shoqëria audituese “Deloitte” në vitin 2020 dhe raportuar në vitin 2021, është kërkuar që të bëhen ndryshimet dhe aprovimet e nevojshme në Pasqyrat Financiare për vitet 2020 dhe 2021 dhe procesi i auditimit të tyre bashkë me pasqyrat financiare të vitit 2022 është akoma në proces. Gjithashtu, në vijim shoqëria ka paraqitur të dhëna sintetike në formë tabelare, lidhur me ushtrimin e aktivitetit të saj, pa dhënë sqarimet dhe argumentat përkatës sikurse parashikuar në metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.
- Në mënyrë që shoqëria FSHU sh.a., edhe për vitin 2024, të mundet të realizojë aktivitetet për të cilat është licencuar, konform ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, bëhet e domosdoshme të vijojë faturimin bazuar në çmimet e miratuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a., për vitin 2024, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërive, do të bëhet korrigjimi dhe kompensimi përkatës i tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 20, gërma “c” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe metodologjive përkatëse, të miratuara nga ERE.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI